**DEKRET**
**Nr. 11882, datë 23.12.2020**

**PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të neneve 93, 125, pika 1, 127, pika 3, 129, 149/d, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 7, 7/a, pika 4, 7/b, 7/dh, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; pasi administrova Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim, dhe Raportin e Arsyetuar të Renditjes së tyre për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtuese (vakancë e parakohshme), e shpallur fillimisht për aplikim nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 10723, datë 7.2.2018, rishpallur me dekretin nr. 11291, datë 27.9.2019, dhe rishapullur për të tretën herë në dekretin nr.11742 datë 24.9.2020 pasi u njoha me praktikën dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për kandidatët e lejuar për plotësimin e kësaj vakance, përcjellë me shkresën nr. 545 prot., datë 23.12.2020; pasi vlerësova kandidatët e ngelur në garë për plotësimin e kësaj vakance; si dhe duke vlerësuar njëkohësisht nevojën jetike që ka vendi për plotësimin dhe funksionimin sa më parë të Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të shqyrtimit vendosa të

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Përparim Kalo emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**